



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1322/3 prot.

Tiranë, më 25.05.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1322/1, DATË 15.05.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË PRAKTIKËS SË PËRCJELLË NGA ISH KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, LIDHUR ME VERIFIKIMIN E ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. FATBARDH GJERGJI NDAJ GJYQTARIT Z. SH.R. NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e z. Fatbardh Gjergji me nr. 450 prot., datë 02.02.2021, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit z. Sh.R., gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe me vendimin nr. 1322/1, datë 15.05.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas verifikimit të praktikës së përcjellë nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, lidhur me verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Fatbardh Gjergji ndaj gjyqtarit z. Sh.R. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës", bazuar në nenin 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kavajë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja nr. 1;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

